

Platforma “Me ty, për Shqipërinë që duam”

Nëpërmjet linkut <https://shqiperiaqeduam.al/>, çdo qytetar/përfaqësues biznesi mund të adresojë problematikën për ndjekje dhe trajtim.

Ky mekanizëm, ushtron funksionet referuar dispozitave ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen” si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje ushtron autoritet mbikëqyrës, koordinues, kontrollues dhe teknik sipas parashikimeve të këtij ligji.

Mënyrat e trajtimit të një ankese/kërkesë

Rastet në platformën e bashkëqeverisjes, vijnë në formën e një ankese për vonesë në marrjen e shërbimit publik apo mospërfitimin e tij, si dhe raportohen sjelljet abuzive të strukturave të administratës shtetërore ose të zyrtarëve të caktuar.

Nëpërmjet platformës, individë/subjekte mund të adresojnë ankesa e kërkesa (vetëm subjektet) drejtuar institucioneve të administratës së pushtetit qendror si dhe atij vendor.

Rubrika - Denonco korrupsionin

Gjithashtu ankimuesit mund të denoncojnë në platformën “Me ty, për Shqipërinë që duam”, aktet korruptive apo kur konstatohet se në përmbajtje të çështjes ka elemente të një akti korruptiv të ndodhur ose në tentative, nëpërmjet seksionit të veçantë “Denonco korrupsionin”.

Ndërveprimi i platformës me institucionet e administratës/individë/subjekte

Ndërveprimi i platformës me individët apo subjektet private dhe me institucionet e administratës shtetërore kryhet vetëm në mënyrë elektronike përmes platformës “Me ty, për Shqipërinë që duam”. Përjashtim bëjnë rastet kur çështjet parashtrihen me shkrim përmes postës në përputhje me rregullat e Kodit të Procedurave Administrative, për shkak të pamundësisë së adresimit në platformë, kur ankuesi nuk ka akses në mjetet e komunikimit elektronik.

Afatet e trajtimit të çështjeve në platformën e bashkëqeverisjes

Afati i trajtimit të ankesave është 10 ditë pune nga data e regjistrimit të ankesës. Për arsye objektive, për shkak të kompleksitetit të çështjes apo të nevojës për ndërveprim ndërinstitucional, kur çështja nuk mund të shqyrtohet brenda afatit prej 10 ditësh pune, institucioni i administratës shtetërore informon Agjencinë për kohën e nevojshme dhe kërkon shtyrjen e afatit me jo më shumë se 10 ditë të tjera pune, shtyrje që miratohet nga Agjencia jo më shumë se dy herë.

Përgjigjet e dërguara për ankimuesit, nëpërmjet platformës “Me ty, për Shqipërinë që duam” përmbajnë qëndrimin zyrtar të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje dhe janë të vlefshme vetëm me nënshkrim elektronik.